



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR
Drejtoria e Përgjithshme

Nr. 2371 Prot.

Tiranë, më 26.03.2020

UDHËZIM

Nr. 6, Datë 26.03.2020

**“MBI LEHTËSIMIN E PROCEDURAVE PËR PACIENTËT QË TRAJTOHEN ME
BARNA ME RIMBURSIM PRANË FARMACISË SË QSUT”**

Në zbatim të ligjit nr. 10383, datë 24.02.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; Kontratës, “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore për vitin 2020”; Kontratës trepalëshe midis Fondit - QSUT - Importuesit Farmaceutik, Kontratës së shërbimit me operatorin shpërndarës farmaceutik me qëllim lehtësimin e procedurave të përfitimit të barit/barnave me rimbursim pranë farmacisë së QSUT si dhe mbrojtjen e shëndetit të pacientëve nga infeksioni i shkaktuar nga Virusi COVID-19;

UDHËZOJ:

I. SHËRBIMI MJEKËSOR UNIVERSITAR - MJEKU SPECIALIST

1. Shërbimi mjekësor universitar dhe mjeku specialist i shërbimit me kontratë me Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, të realizojnë konsultën on-line me pacientin që trajtohet me barna me rimbursim të cilat tregtohen në farmacinë e QSUT-së. Konsulta do të realizohet nëpërmjet telemjekësisë apo çdo komunikimi telefonik/elektronik (skype, ehatsapp, viber, etj).
2. Në rastet kur vlerësohet e nevojshme, për periudhën në fuqi të këtij udhëzimi, mjekët specialistë përkatës të spitaleve rajonale dhe bashkiake, në bashkëpunim me shërbimet mjekësore të QSUT, do të realizojnë konsultën mjekësore për këta pacientë.
3. Mjeku specialist i shërbimit mjekësor të QSUT do të gjenerojë recetën elektronike me rimbursim në sistemin eRx pas konsultës on-line për barnat për të cilat është i mundur aplikimi i tyre në banesë ose spital rajonal/bashkiak dhe nuk është i nevojshëm hospitalizimi në QSUT/ekzaminime specifike për aplikimin e tyre. Kodet e recetës elektronike do t'i dërgohen specialistëve të DSHSU nga mjeku specialist nëpërmjet komunikimit telefonik/elektronik.

4. Pacientët të cilët trajtohen me këto barna do të jenë nën kujdesin e mjekut specialist rajonal/bashkiak për çdo shfaqje të efekteve anësore, që mund të vërehen, si edhe në kontakt të vazhdueshëm apo dhe monitorim nga mjeku i përgjithshëm dhe i familjes.

II. DREJTORIA E SHËRBIMEVE SPITALORE UNIVERSITARE (DSHSU)

1. DSHSU, pasi të ketë marrë kodet e recetës/recetave elektronike nga mjekët e shërbimeve mjekësore të QSUT, kontakton dhe dakortëson në rrugë telefonike/electronike me pacientin për përzgjedhjen e alternativës tregtare të barit/barnave me rimbursim.
2. DSHSU, konfirmon recetën elektronike në sistem dhe e kontrollon atë, në përputhje me udhëzimin për barnat spitalore, protokollet e përdorimit të barnave dhe kufizimet e listës së rimbursuar.
3. DRF/Degë/Agjensi, konfirmon bashkëpagesën e barit/barnave me rimbursim në çdo rast kur do të ketë të tilla, nisur nga përzgjedhja e alternativës tregtare të barit/barnave nga pacientët dhe njofton elektronikisht DSHSU.
4. DRF/Degë/Agjensi, arkëton vlerën e bashkëpagesës së barit/barnave me rimbursim për pacientët dhe dërgon shumën e arkëtuar në llogarinë e DSHSU, si dhe nëpërmjet shërbimit postar një kopje të mandat pagesës bankare.
5. DSHSU, printon recetën elektronike nga sistemi eRx në tre kopje dhe i dërgon ato në farmacinë e QSUT.
6. DSHSU, plotëson të dhënat e formularit tip të hartuar nga Fondi mbi Autorizimin për operatorin e shpërndarësit farmaceutik.

III. FARMACIA SPITALORE NË QSUT

1. Të marrë masat e nevojshme për mbarëvajtjen, kushtet e ruajtjes dhe menaxhimin e barit/barnave me rimbursim të përdorimit spitalor.
2. Të pregatisë në kohë reale kërkesën me barin/barnat me rimbursim për depon furnizuese.
3. Të kryejë ekzekutimin e recetës me rimbursim për barin/barnat, duke zbatuar të njëjtat procedura (dhe plotësuar dokumentacionin përkatës) si në rastin kur pacienti paraqitet fizikisht në farmacinë pranë QSUT.
4. Të pregatisë barin/barnat me rimbursim sipas recetave të printuara nga sistemi eRx, ku shprehet qartë alternativa e barit/barnave me rimbursim me ose pa bashkëpagesë, sipas rajoneve përkatëse, për operatorin e shpërndarësit farmaceutik, duke i shpjeguar kushtet e ruajtjes së barit/barnave me rimbursim.

5. T'i dorëzojë operatorit të shpërndarësit farmaceutik barin/barnat me rimbursim të përgatitura sipas rajoneve, bazuar në autorizimin e DSHSU, i cili duhet të nënshkruhet nga farmacisti i QSUT.

IV. OPERATORI SHPËRNDARËS FARMACEUTIK

1. Mban përgjegjësi për tërheqjen e barit/barnave me rimbursim nga farmacia e QSUT-së, bazuar në kontratën e shërbimit me Fondin.
2. Realizon tërheqjen e barit/barnave me rimbursim sipas rajoneve, bazuar në autorizimin e DSHSU, i cili duhet të nënshkruhet nga personi i autorizuar i operatorit shpërndarës farmaceutik.
3. Siguron kushtet e ruajtjes dhe të shpërndarjes së barit/barnave me rimbursim që nga marrja në dorëzim nga farmacia e QSUT, gjatë transportit të tyre dhe deri në dorëzimin e barit/barnave me rimbursim në farmacinë e spitalit rajonal/ bashkiak.
4. Siguron në raste të veçanta shpërndarjen dhe dorëzimin e barit/barnave për atë kategori pacientësh që janë të vetmuar dhe mbi 65 vjeç pensionistë.

V. FARMACIA E SPITALIT RAJONAL/ BASHKIAK

1. Mban përgjegjësi për marrjen në dorëzim të barit/barnave me rimbursim nga operatori shpërndarës farmaceutik, bazuar në autorizimin e DSHSU dhe të kopjeve të recetave elektronike të printuara nga sistemi eRx. Autorizimi i DSHSU, nënshkruhet nga farmacisti i spitalit rajonal/bashkiak.
2. Merr masat e nevojshme për mbarëvajtjen, kushtet e ruajtjes dhe menaxhimin e barit/barnave me rimbursim të përdorimit spitalor.
3. Bashkëpunon dhe koordinon punën me DRF/Degë/Agjensi duke realizuar dorëzimin e barit/barnave me rimbursim tek pacientët.

VI. DREJTORIA RAJONALE / DEGA / AGJENSIA

1. Merr masat e nevojshme për njoftimin e mjekëve specialistë të spitaleve rajonale/bashkiake, mjekëve të përgjithshëm dhe të familjes si dhe farmacitë e spitaleve rajonale/bashkiake lidhur me zbatimin e pikave të këtij udhëzimi.
2. Merr masat për njoftimin e pacientëve për përfitimin e barit/barnave me rimbursim pranë farmacisë së spitalit rajonal/bashkiak si dhe në lidhje me kryrjen e bashkëpagesës së alternativës së barit/barnave me rimbursim, në rastet kur ka të tilla, bazuar në listën e DSHSU.

5. DRF/Degë/Agjensi realizojnë dhe konfirmojnë cdo ditë bashkëpagesat e barit/barnave me rimbursim në rastet e përzgjedhjes së alternativave tregtare nga pacientët dhe njofton elektronikisht DSHSU.
6. DRF/Degë/Agjensi arkëton vlerën e bashkëpagesave për pacientët dhe dërgon shumën e arkëtuar në llogarinë e DSHSU, gjithashtu dërgon nëpërmjet shërbimit postar pranë DSHSU një kopje të mandat pagesës bankare.

Për zbatimin e këtij udhëzimi, ngarkohen Drejtorja e Shërbimeve Spitalore Universitare, Drejtoritë Rajonale/Degët/Agjencitë e Fondit, Farmacia Spitalore e QSUT/Spitaleve rajonale/bashkiake.

Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet përgjatë gjithë kohës së rrezikut nga epidemia e shkaktuar nga Virusi COVID-19.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Rudina Degjoni

